

DEKLARATË E PËRBASHKËT

VERSION I ZGJERUAR

KONFERENCA I E PËRBASHKËT SHKENCORE
NISMA NDËRQEVERITARE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR



Intergovernmental Initiative Western Balkans

Joint Science Conference

1. Pas konferencës ndërqeveritare për Ballkanin Perëndimor, e zhvilluar më 28 gusht 2014 në Berlin, Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave "Leopoldina", në marrëveshje me Qeverinë Federale Gjermane, mori drejtimin e nismës në fushën prioritare të çështjeve akademike dhe shoqërore duke organizuar Konferencën e parë të përbashkët shkencore më 15-17 korrik 2015 në qytetet Halle dhe Berlin të Gjermanisë.
2. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të akademive kombëtare dhe konferencave të rektorëve dhe studiues të njohur, me ftesë personale nga Leopoldina dhe fondacioni "Alexander von Humboldt". Pjesëmarrësit qenë nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Kosova*, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia, si edhe nga Austria, Italia dhe Gjermania. Të pranishëm si vëzhgues ishin edhe përfaqësues diplomatikë në Gjermani, përfaqësues të Qeverisë Federale Gjermane dhe të Komisionit të Bashkimit Evropian.
3. Ne, pjesëmarrësit në konferencë, kemi identifikuar çështje kyçe, që kanë nevojë imediate për vëmendje dhe reforma. Në Ballkanin Perëndimor ka një pamjaftueshmëri kronike të fondeve publike dhe private për shkencën dhe studime (niveli i tanishëm i shpenzimeve është ndjeshëm më poshtë se objektivi i BE-së, sipas të cilit duhet të zërrë 3% të PBB-së). Saktësia në planifikim pengohet nga fokusi afatshkurtër dhe qasjet shpërndarëse për financimin. Studiuesit e rinj e kanë të vështirë të futen në sistem. Emigrimi në masë (sidomos largimi i trurit) është një rrezikshmëri ndër më të mëdhatë për zhvillimin e ardhshëm të Ballkanit Perëndimor. Nuk ekzistojnë lidhje të mjaftueshme midis burimeve ekzistuese, infrastrukturave, projekteve dhe njerëzve në sistemet shkencore. Dijet nuk shkëmbehen dhe nuk përhapen në mënyrë sistematike. Kjo çon në një shkallë të lartë izolimi/orientimi drejt vetes të sistemeve shkencore kombëtare. Shkencën dhe rezultatet e saj rrallë përfshihen në vendimmarrje dhe në krijimin e opinionit. Dijet e fituara nga studiuesit shkojnë dëm duke qenë se nuk përdoren në interes të politikës dhe shoqërisë.
4. Prandaj, ne sugjerojmë zgjidhjet e mëposhtme për ta ndryshuar këtë situatë:
5. Nevojiten fonde adekuate për të mbështetur arsimin, studimin dhe novacionin në Ballkanin Perëndimor. Mbështesin fuqimisht objektivin e caktimit të 3% të PBB-së së vendeve, për arsimin e lartë dhe shkencën. Saktësia në planifikim dhe financimi i qëndrueshëm janë kushte për zhvillimin strategjik të sistemeve shkencore: jo vetëm planifikim afatshkurtër, por edhe qasje afatmesme dhe afatgjata, jo vetëm shpërndarje, por edhe konkurrencë. Për të siguruar një vlerësim të saktë të ecurisë, duhen vendosur standarde të unifikuara për cilësinë—brenda Ballkanit Perëndimor dhe në mbështetje të standardeve të BE-së.
6. Shkencëtarët e rinj janë element kyç i shkencës. Atyre u duhet një perspektivë e besueshme në vendet e tyre, duke filluar menjëherë pas diplomimit, për t'ua bërë tërheqës qëndrimin dhe angazhimin në sistemet shkencore, për të kontribuar kështu në përparimin e vendit të tyre dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor në tërësi. Kërkimi shkencor lipset të vlerësohet për vlerën thelbësore që ka për shoqërinë. Shkencëtarët që punojnë jashtë shtetit (diaspora akademike e Ballkanit Perëndimor) është mirë të nxitet të kthehet nëpërmjet projekteve ndërkuftare dhe nismave për kthimin e trurit, duke krijuar një kulturë mirëpritëse për shkencëtarët e kthyer. Rekomandohet krijimi i regjistrave depozitues për diasporën akademike (për shembull, në bazë të CORDIS).
7. Shkencëtarët e shkëlqyer kanë aftësinë të funksionojnë si agjentë të ndryshimit. Me prioritetin më të lartë është mbështetja e punës kërkimore të tyre me fond me destinacion të përcaktuar. Rekomandojmë fuqimisht krijimin në kohën e duhur të një këshilli për kërkimin shkencor të Evropës Juglindore (KKSHEJ) (në konsorcium të përbashkët me Këshillin Evropian për Kërkimin Shkencor dhe institucionet që japin fonde për kërkimin shkencor në vendet e Ballkanit Perëndimor) ose të një fondacioni për kërkimin shkencor të Evropës Juglindore (FKSHEJ), ku në secilin rast theksi do t'i vihej financimit të individëve në bazë të meritave. Për këtë kërkohen kritere transparente përzgjedhjeje, të orientuara vetëm nga procedura për vlerësimin dhe rezultatet akademike në përputhje me standardet ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e vlerësuesve të huaj.
8. Potenciali shumë i madh shkencor i vendeve të Ballkanit Perëndimor është mirë që, sidomos në kohëra të kufizimeve buxhetore dhe paqëndrueshmërisë politike, të grumbullohet në rrjete të qendrave të përqendrimit të njohurive (deri në pesë). Është mirë që qendra të tilla ndërdisiplinore të qëndrojnë mbi nivelin kombëtar dhe të kenë tri detyra madhore: ⁽ⁱ⁾ kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar të fjalës së fundit, ⁽ⁱⁱ⁾ formim doktrature dhe pasdoktrature që është konkurrues në arenën ndërkombëtare dhe ⁽ⁱⁱⁱ⁾ transferim të rezultateve të kërkimit shkencor. Kjo do t'i rrisë mundësitë e përfitimit nga fondet e BE-së. Fusha të mundshme tematike mund të ishin mjedisi dhe energjetika, trashëgimia kulturore, ndryshimet demografike, turizmi, drejtësia dhe siguria, shëndeti dhe cilësia e jetës, teknologjia informatike dhe e komunikimit dhe zhvillimi rajonal dhe vendor.

Hyrje

Grupet e interesit

Gjendja e tanishme: Sfidat përpara të ardhmes evropiane të sistemeve shkencore të Ballkanit Perëndimor

Qëndrueshmëri në financim dhe standarde të unifikuara për cilësinë

Shkencëtarët e rinj dhe largimi i trurit / kthimi i trurit

KKSHEJ / FKSHEJ dhe individët e shkëlqyer si agjentë të ndryshimit

Potenciali shkencor i bashkuar në qendra rajonale të përqendrimit të njohurive

* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GjND-së "Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës".

9. Për të pasur objekte të fjalës së fundit në Ballkanin Perëndimor me kontribut financiar të menaxhueshëm, burimet dhe infrastrukturën (arsimore, kërkimore, objektet bazë etj.) është mirë të përdoren bashkërisht. Ekzistojnë tashmë formate bashkëpunimi me fokusin tek Ballkani Perëndimor (si Platforma rajonale për vlerësimin e krahasuar dhe bashkëpunimin në arsimin e lartë) që është mirë të fuqizohen dhe zgjerohen.
10. Sistemet shkencore të Ballkanit Perëndimor lipsen integruar brenda rajonit dhe lidhur me BE-në. Rekomandojmë bashkëpunimin në projekte binjakëzimi midis partnerëve nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor, organizimin e programeve të përbashkëta studimore në nivel Master dhe PhD dhe mundësimin që shkencëtarët nga Ballkani Perëndimor ta kenë më të lehtë të përfitojnë nga programet kërkimore shkencore të financuara nga BE-ja. Është mirë të zhvillohen skema të lëvizshmërisë, të cilat të lidhin shkencëtarët nga Ballkani Perëndimor dhe BE-ja: ⁽ⁱ⁾ duke ndihmuar në udhëtimin jashtë shtetit për shkencëtarët dhe studentët nga rajoni i Ballkanit Perëndimor (për shembull, përmes thjeshtimit të kriterëve për pajisjen me vizë), ⁽ⁱⁱ⁾ duke krijuar një program rajonal shkëmbimi (mbështetur në shembullin e programit “Erasmus” ose duke u integruar në programin ekzistues “Erasmus”) dhe ⁽ⁱⁱⁱ⁾ duke filluar nisma të tjera për shkëmbimin e të rinjve në mënyrë dypalëshe ose shumëpalëshe (një shembull i suksesshëm është shkëmbimi i të rinjve midis Gjermanisë dhe Francës dhe Universiteti Gjermano-Francez).
11. Lipsen zbatuar mekanizma të institucionalizuar për dialogun shkencë-politikë-shoqëri në Ballkanin Perëndimor. Palët pjesëmarrëse janë të gatshme të shkëmbejnë dije dhe mbështetje teknike për rritjen e kapaciteteve. Një mekanizëm këshillimor shkencor i ngjashëm me atë që përdoret në samitet e grupit G7 është mirë të realizohet për Nismën ndërqeveritare për Ballkanin Perëndimor.
12. Të ketë konferenca vjetore të përbashkëta shkencore—si një prej shtyllave të të ashtuquajturit “Procesi i Berlinit”—që të shërbejnë si platformë/ombrellë për bashkëpunimin në sistemin shkencor dhe në dimensionin e gjerë shoqëror. Konferencat është mirë të identifikojnë sfidat në sistemin shkencor dhe të hartojnë zgjidhje të qëndrueshme si edhe të shprehin rekomandime për politikën. Është mirë që përparimi i arritur të vlerësohet dhe analizohet në mbledhje vjetore me tema të ndryshme. Bashkërendimi të sigurohet nga një sekretariat.
13. Tani i duhet dhënë formë një të ardhmeje të përbashkët evropiane dhe Ballkani Perëndimor është pjesë e pandashme e kësaj—mbajtja e statusit kuosë nuk është njëra prej zgjedhjeve. Prandaj ne i mbështetim me vendosmëri përpjekjet për bashkëpunim, pajtim dhe integrim në Ballkanin Perëndimor. Rekomandojmë që vëmendje e veçantë t’u kushtohet të rinjve, si forca shtytëse e ndryshimit pozitiv. Shkencat dhe studimet shoqërore të konsiderohen si investim i vazhdueshëm në të ardhmen. Në përgjigje të sfidave të identifikuara dhe për të vënë në jetë zgjidhje të qëndrueshme në kohë, i rekomandojmë Samitit për Ballkanin Perëndimor, të mbajtur në Vjenë më 27 gusht 2015, sa më poshtë:
1. Të merret angazhimi për të arritur në 3% GDP shpenzimet për arsimin e lartë, shkencën dhe kërkimin shkencor dhe të vendosen standarde të unifikuara për vlerësimin;
 2. Të mbështetet me vendosmëri ndryshimi institucional ⁽ⁱ⁾ që i modernizon sistemet shkencore të Ballkanit Perëndimor në konvergencë me standardet e BE-së, drejt integritimit në Zonën Evropiane të Kërkimit dhe ⁽ⁱⁱ⁾ që u jep mundësi studiuesve të rinj dhe të diplomuarve, duke e zvogëluar kështu largimin e trurit nga vendi dhe duke nxitur kthimin e trurit;
 3. Të krijohet një këshill ose fondacion për kërkimin shkencor të Evropës Juglindore, që të financojë shkencëtarët të veçantë të jashtëzakonshëm si agjentë të ndryshimit, duke përdorur një mekanizëm përzgjedhjeje me konkurrencë mbështetur vetëm tek cilësia e punës kërkimore dhe rezultatet akademike;
 4. Të krijohet qendra të ndërlidhura të përqendrimit të njohurive në Ballkanin Perëndimor, si platforma bashkëpunimi: ⁽ⁱ⁾ duke i bashkuar burimet dhe aftësitë, ⁽ⁱⁱ⁾ duke investuar bashkërisht në objekte qendrore dhe infrastruktura kërkimore të fjalës së fundit, ⁽ⁱⁱⁱ⁾ duke mbështetur lëvizshmërinë e studiuesve dhe të studentëve, ^(iv) duke krijuar formim konkurrues doktrature dhe pasdoktrature dhe ^(v) duke krijuar komunitete novacioni;
 5. Të institucionalizohet dialogu midis shkencës, politikës dhe shoqërisë, ⁽ⁱ⁾ duke krijuar mekanizma konsultimi dhe planifikimi strategjik dhe ⁽ⁱⁱ⁾ duke vendosur procedura për t’i ofruar politikës dhe shoqërisë këshilla të mbështetura jo në paragjykim por në shkencë.

Grumbullimi në një vend i përpjekjeve dhe përdorimi i rrjeteve ekzistuese

Bashkëpunimi, qëndrimi në lidhje, lëvizshmëria

Shkencë-politikë-shoqëri: Dialog i institucionalizuar

E ardhmja e konferencës së përbashkët shkencore si një shtyllë e “Procesit të Berlinit”.

Rekomandime për politikën, në Samitin e Vjenës për Ballkanin Perëndimor, të mbajtur më 27 gusht 2015